



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS
ZYRA VENDORE ARSIMORE TIRANË

NJOFTIM

Subjektet që kryejnë praktikën profesionale:

- 1. Kanë të drejtën për të zhvilluar praktikën profesionale kandidati, që ka fituar diplomën universitare në fushën e mësuesisë sipas ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Mbeshtetur në nenin 57 të ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Aplikimi për zhvillimin e praktikës profesionale për vitin shkollor 2024-2025 duhet të kryhen në portalin **e-albania***

Afati i aplikimit në portal për periudhën e parë për zhvillimin e praktikës profesionale për vitin shkollor 2024-2025 është nga prej datës 02.09.2024 - 06.09.2024 deri në orën 12:00.

Dokumentacioni që kërkohet të ngarkohet në portal nga kandidatët :

1. CV e praktikantit;

2. Fotokopje e noterizuar e diplomes Bachelor me lista notash;
3. Fotokopje e noterizuar e diplomes Master me lista notash;
4. Raporti mjeko- ligjor nga qendra shëndetsore e njësisë së banimit;

☐ Në mungesë të pajisjes me diplomë të ciklit të dytë të studimeve, kandidati për praktikant duhet të pajiset nga Universiteti përkatës me një vërtetim ku të specifikohet që ai/ajo:

- **Ka shlyer të gjitha detyrimet për përfundimin e ciklit të dytë të studimeve në edukim.(si dhe njohjen e gjuhës së huaj,në bazë të testimeve të njohura ndërkombëtare dhe në nivelin e specifikuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi);**-emërtesa e plotë dhe lloji i programit të ciklit të dytë të përfunduar

a-viti i përfundimit

b-numri i matrikullimit

c-data e diplomimit